



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Zyra e kryetarit

Klinë: 30.01-2023

REPUBLIC OF KOSOVO

MUNICIPALITY OF KLINA

Punuar nga dt. 30.01.2023

Procedura e punës

01-06-3469/23

PROCESVERBAL

Nga takimi i dytë i kryetarit të Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj me qytetarët e Komunës së Klinës, mbajtur me datë 23. 12. 2022 në sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora 10:00

Kryetari z. Elezaj falënderoj qytetarët pjesëmarrës në këtë takim duke jua bërë të ditur që në vazhdim në pika të shkurtra do të ju jap informacion dhe një raport për punën e bërë të ekzekutivit.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Përshëndetje të gjithëve. Mirë se keni ardhë në këtë takim që bashkë të i diskutojmë të gjitha të arriturat në të gjitha sferat e pushtetit lokal në Komunën e Klinës. Ka qenë një vit i shoqëruar me shumë sfida dhe atë që nga fillimi duke e pasur parasysh situatën globale me rritjen e çmimeve dhe që edhe tek ne ka pasur efekt negativ. Të gjitha firmat me të cilat kemi pasur kontrata të nënshkruara hezitonin të fillonin punën duke kërkuar rritje të vlerës së kontratave. Ne në nivel lokal nuk e kishim mundësinë e rritjes së vlerës pasi që kjo është kompetencë e nivelit qendror përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kjo është rregulluar në fund para një muaji. Duke e pasur parasysh këto vështirësi, unë jam i kënaqur me realizimin e projekteve. Çështja e dytë ka qenë fillimi i procesit të prokurimit me projekte të reja në këtë vit e që parashikimi dhe ndarjet buxhetore kanë qenë nga viti i kaluar. Edhe kjo ishte vështirësi e madhe pasi që të tjera ndarje buxhetore ishin bërë vitin e kaluar e të tjera çmime diktoheshin nga kriza globale këtë vit. Shembull, kur kemi bërë ndarjen buxhetore sipas planifikimit në vitin e kaluar me 100 mijë euro të ndara për shtrimin e tre kilometrave rrugë me asfalt jemi detyruar që ta reduktojmë në një kilometër shkaku i rritjeve të çmimeve. Jemi detyruar që të i përsërisim procedurat e prokurimit. Me gjithë këtë me angazhimin maksimal të ekzekutivit sot mund të them se është shpenzuar buxheti 80.39% që është një arritje e mirë, ndërsa në projektet kapitale është 66.9% e buxhetit të shpenzuar. Mundësi për kryerjen pagesave ka edhe dy tre ditë dhe shpresojmë që do të arrijmë minimumin nga shpenzimi i buxhetit nga projektet kapitale në 75% që është kusht për përfitimin e grandeve. Ne ende nuk e kemi vlerësimin përfundimtar por këtë vit jemi një nga 6-shtë komunat më të mira për performancë. Jemi të kualifikuar si komunë e tillë dhe do të shpërblehemi me grandin e performances që tani për tani flitet që do të jetë 800 mijë euro. Në aspektin

e përgjithshëm mund të them se projektet kapitale kanë ecur mirë ato që janë menaxhuar nga Komuna e Klinës. Ndërsa projektet që janë menaxhuar nga CDI etj. kanë nga pak vonesa por që do të kryhen gjithsesi shumë shpejtë. Në këtë fillim viti është formuar nga një komision nga Kryeministri i republikës bashkë me Komunën e Klinës për ujin e pijshëm. Komuna me buxhetin e vet nuk mund ta kryej investimin për këtë problematikë pasi që duhet të kemi më shumë se 10 milion euro. Po ashtu, në raportin është pranuar nga qeveria vizioni i jonë për fabrikën e ujit. Një projekt tjetër i rëndësishëm është trajtimi i ujerave të zeza. Ne me kapacitetet tona çdo vit po ndërtojmë nga një impiant. Është ndërtuar në Volljak, në Sferkë tani më kanë përfunduar punimet etj. Zgjidhja përfundimtare për trajtimin e ujerave të zeza do të bëhet me qeverinë pasi që është projekt që kapë vlerën deri në 10 milion euro. Aspekt tjetër që ka krijuar vështirësi është periudha e vërshimeve. Edhe pse kemi bërë investime të konsiderueshme në pastrimin dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve prap se prap ka pasur probleme. Detyrimsht duhet të kemi buxhet më të madh që investimi të jetë akoma më i madh pasi që duhet të jemi të kujdesshëm në këtë drejtim sepse Klinën e përfshijnë 5 lumenj.

Unë nuk do të zgjatem me tepër. Jam i gatshëm që të bashkëbisedojmë dhe shqyrtojmë të gjitha kërkesat dhe idetë e juaja. Përveç kësaj zyra e ime ka qenë gjithmonë e hapur për çdo qytetar të Komunës së Klinës.

Pasi që asnjëri nga të pranishmit nuk morri fjalën në vazhdim të këtij takimi, kryetari i Komunës. Z. Zenun Elezaj, falënderoj të gjithë për pjesëmarrje dhe duke ju uruar festat e fund vitit e mbylli këtë takim.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryetari i Komunës

Zenun Elezaj

